



Plani i Punëve Punëve - Projekti Retirement Deputy	19.01.24	viti god year
Organ - Niveli Organi - Jedinita Org. Unit	Nr. Prot. B. Prot. Prot. No.	Shënimi Prilog Appendix
SKM/SHK/371/2024		Sasia Kolicina Quantity
		1/5

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A nr.983/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabnai-anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.A.nr.876/2022 të datës 10.11.2023 të Gjykatës së Apelit/Departamenti për Cështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.983/2022 të datës 23.03.2018, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 19.01.2024 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr151/2018 e datës 23.03.2018 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Me Vendimin e datës 18.12.2017 me numër protokoli 6683/17 të Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ankueses „Zyrtare Financiare” në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 18.01.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesja me datë 02.02.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 597-2/18 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit dhe pagesën e shpërblimit jubilar, duke u bazuar në nenin 53 të marrëveshjes së përgjithshme kolektive të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, edhe përkundër obligimit ligjor nuk e ka shqyrtuar ankesën e ankueses të datës 02.02.2018.

Ankuesja kundër heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me datë 23.03.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1657/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.03.2018 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuese në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ndërsa Këshilli nga kjo e fundit më datë 04.04.2018, ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 18.05.2018 ka nxjerr Vendimin me numër A.nr 151/2018 përmes së cilit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e datës 23.03.2018 të parashtruar nga ankuesja. Ankuesja e pakënaqur me vendimin me numër A.nr.151/2018 të datës 18.05.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit përmes Aktgjykimit me numër A.nr.627/18 të datës 10.10.2022 e ka aprovuar si të pa bazuar kërkespadinë e paditësës, duke e anuluar vendimin me numër A.nr.151/2018 të datës 18.05.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Aktgjykimit me numër 627/18 të datës 10.10.2022 të Gjykatës Themelore/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 24.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 73.85/2022 në Gjykatën e Apelit/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata e Apelit/Departamenti për çështje Administrative më datë 17.11.2023 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.A.nr.876/2023 përmes së cilit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e datës 24.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e vërtetuar Aktgjykimin me numër A.nr.627/18 të datës 10.10.2022 të Gjykatës Themelore/Departamenti për çështje Administrative duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.A.nr.876/2022 të datës 10.11.2023 të Gjykatës së Apelit/Departamenti për çështje Administrative; E-mailin e datës 10.10.2022; Ankesa me numër A.nr.627/18 e datës 24.11.2022 nga Këshilli i Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës drejtuar Gjykatës së Apelit/Departamenti për çështje Administrative; Autorizimin me numër protokoli 7384/2022 të datës 24.11.2022; Aktgjykimin me numër A.nr.627/18 të Gjykatës së Apelit/Departamenti për çështje Administrative të datës 09.11.2022; Autorizimin me numër protokoli 5984/2022 të datës 07.10.2022; Thirrjen për shqyrtimin kryesor me numër 627/18; Përgjigjen në padi me numër protokoli 4794/2022 të datës 18.08.2022; Aktvendimin me numër protokoli 4257/2022 të datës 22.07.2022 të Gjykatës Themelore/Departamenti për çështje Administrative; Procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 20.04.2021; Padinë e datës 22.02.2018; Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile të datës 18.04.2016; Librezën e punës me numër 23959; Akt Emërimit e datës 03.08.2015; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 18.01.2018; Gjendjen e llogarisë të datës 23.01.2018; Autorizimin e datës 22.02.2018; Dëshmi me numër C.nr.636/18 të datës 02.03.2018; Vendimin me numër A.nr.151/2018 të datës 18.05.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Procesverbalin e Kolegjit për Ankesa me numër A.nr.151/2018 të datës 16.05.2018; Ankesën me numër protokoli 1657/2018 të parashtruar nga ankuesja më datë 23.03.2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.215/2017 të datës 15.12.2017 të lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së; Dëshminë e datës 01.01.2018; Ankesën me numër protokoli 5972/18 të datës 02.02.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.03.2018; Përgjigjen në ankesë të datës 04.04.2018; Listën e pagave me numër 10-11310-210-0660 për periudhën kohore 01.01.2018 deri më 31.01.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e paraqitura, konstatoi se *ankesa është e pabazuar, sepse:*

Sipas Aktgjykimit me numër A.nr.627/2018 të datës 10.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative në të cilin është theksuar se me Vendimin e Këshillit, nuk janë trajtuar qartë pretendimet ankimore të palës paditëse sipas kërkesës së saj respektivisht kompensimi i pagave jubilarë sipas nenit 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, ashtu qe arsyetimi i vendimit nuk korespondon me kërkesat specifike të palës paditëse dhe nuk përmbanë dëshmi të plota e të doemosdoshme mbi bazën e të cilave është refuzuar ankesa. Nga vendimi i kontestuar del se i njëjti është përfshirë në shkelje të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkak të arsytimit të dhënë organi i paditur nuk i ka dhënë përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme në raport me ankesën e palës paditëse. Këshilli pas rishqyrtimit të ankesës sipas Aktgjykimit të lartpërmendur ka konstatuar se sipas Vendimit me numër protokollit 6683/17 të datës 18.12.2017 të Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ankueses „Zyrtare Financiare“ në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga data 18.01.2018, i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe po ashtu i është njohur edhe kompensimi i një (1) pagë mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit

Tutje Kolegji i Këshillit pas analizimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë të datës 17.11.2023 dhe Aktgjykimit me numër A.nr.627/2018 të datës 10.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative i cili e ka obliguar Këshillin që konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duhet që të shqyrtoj përsëri ankesën e ankueses për shkak se e paditura në këtë rast Këshilli nuk ka trajtuar qartë pretendimet ankimore të palës paditëse e gjithashtu vlerëson se nuk është argumentuar me asnjë provë se aktgjykimi i i ankimuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës administrative dhe kontestimore, ndërsa Gjykata e shkallës së parë i ka treguar dhe arsyetuar në tërësi faktet vendimtare të bazuara. Pas analizimit të pretendimit lidhur me kompensimin e dy pagave jubilarë siç kërkon ankuesja në ankesën e datës 23.03.2018 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës e cila duke u bazuar në nenin 52 të Marrëveshjes Kolektive të Kosovës kërkon kompensimin e dy (2) paga jubilarë, e cila përcakton se; i punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ky pretendim është i pa bazuar sepse sipas Akt Emërimit të datës 03.08.2018 në vendin e punës „ Zyrtare e Financave“ në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, gjegjësisht sipas vendimit me numër Nr.6683/12 të datës 18.12.2017 ankuesja është pensionuar që nga data 18.01.2018, dhe se nuk ka arritur dhjetë(10) vjetorin për t’ju kompensuar paga jubilarë, ashtu siç është paraparë edhe me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil pasi që ankuesja për të marr një pagë jubilarë është dashur të jetë në marrëdhënie punë deri në vitin 2021 respektivisht e njëjta nuk ka arritur dhjete (10) vite pune pa ndërprerë ashtu siç është parapare edhe me nenin 21 të Rregullores Nr. 33/12 per Shtesat ne Page dhe Kompensime të Tjera i cila ka përcaktuar se,, Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin

Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune". Andaj duke pasur parasysh këtë pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuara.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë të datës me numër A.A.876/2022 të datës 10.11.2023 ka rishqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cili pretendon sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212 si dhe dispozitave të nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës i takojnë dy paga jubilarë si dhe dy paga përcjellëse me rastin e pensionimit, dhe ka konststuar se pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar, sepse për kompensimet e nëpunësve civilë ne ate kohe kanë qene të aplikueshme dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nëpunësve civilë me rastin e pensionimit ju takon kompensimi në vlerën e një page të njëhershme të pagës së fundit, e jo dy (2) pagave siç ankuesi pretendon, e kjo është e përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë që nëpunësi civil ka të drejtë të kompensohet me rastin e pensionimit dhe të dispozitave të nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, që përcakton se: *"1. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës përcakton se: *"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes, dhe meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, është tërhequr andaj Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja marrëdhënien e punës së me rastin e pensionimit e ka përfunduar sipas Vendimit Nr.6683/17 të datës 18.12.2017 në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, se rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 6683/17 tw datës 18.12.2017 të për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit për ankuesen Hajrije Bunjaku si dhe kompensimin e një page pas moshës së pensionimit, është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marrë në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e

Nëpunësve Civilë si dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i aplikueshëm në atë kohë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.983/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore -GASHI-BAIRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Gjykatës së Apelit/Departamenti për Cështje Administrative Gjyqetares Delushe Halimi;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë//Departamenti për Cështje Administrative Gjyqetarit Kreshnik Kaçiu;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

